

BIOGRAFI E SHKURTËR

Gani Gërguri u lind në Istog, Kosovë, në vitin 1960. Ka diplomuar në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës me shpërblimin “Student i dalluar”, ndërsa pas kësaj ka përfunduar studimet postdiplomike në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Zagrebit, Kroaci, në drejtimin e menaxhmentit. Në vitin 2009 ka përfunduar studimet për magjistër në financa në Universitetin të Shefildit, me rezultat të shkëlqyeshëm.

Karriera e z.Gërguri filloi në drejtorin e analizave dhe statistikave në Bankën Popullore të Kosovës, në vitin 1983. Në vitin 2000, z. Gërguri punësohet në BQK si udhëheqës i departamentit për kërkime dhe statistikë, ndërsa në vitin 2004 promovohet në Zyrtar kryesor të operacioneve të BQK-së. Në janar të 2006, z. Gërguri emërohet Zëvendësdrejtor i përgjithshëm i BQK-së, më pas në shtator të 2008, Bordi drejtues i BQK-së e emëroi Zëvendësguvernator përgjegjës për funksionet bankare qendrore. Që nga 26 korriku i vitit 2010, z.Gërguri është UD i Guvernatorit të BQK-së.

Z. Gërguri kryeson Komitetin për statistika dhe analiza ekonomike dhe njëkohësisht është kryeredaktor i publikimeve periodike dhe të veçanta të Bankës Qendrore. Gjithashtu, është bashkëkryesues i Këshillit kombëtar të pagesave dhe anëtar i Bordit për njësinë e inteligjencës financiare të Kosovës.

Z. Gërguri ka marrë pjesë dhe ka kontribuar në shumë konferenca ndërkombëtare në çështjet e bankingut qendror dhe të stabilitetit financiar. Gjithashtu, ka përfunduar kursin specialistik tremujor të Fondit Monetar Ndërkombëtar në Uashington në lëmin e Programimit dhe Politikave Financiare si dhe kurset tjera specialistike në fushën e Vlerësimit të Qëndrueshmërisë së Bankave Qendrore, Statistikat Monetare e Financiare, etj.

Gjithashtu, ai ka përfunduar me sukses të shkëlqyeshëm programin njëvjeçar të Zhvillimit Profesional dhe Lidershit të organizuar nga ana e USAID-it.

Lëmit e interesit të veçantë përfshijnë: ekonomiksi dhe stabilitet financiar, makroekonomi, sistemet e pagesave dhe qeverisja e korporatave.

Flet gjuhën angleze dhe serbe.

Është i martuar me Muzaferen dhe ka dy fëmijë, Elioni (18) dhe Arioni (14).